



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. 56/19
Datë: 19.11.2019

Në mbështetje të nenit 23, neni 28 dhe 29 të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS si dhe Ligji për plotësim ndryshim i tij Nr. 04/L-226, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Ahmet Krasniqi - Zv. Kryetar, Fatime Haziri – Anëtar dhe Shaqir Morina Anëtar, - Lidhur me kërkesën nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit-Departamenti i Aviacionit Civil mbi vlerësimin e çështjes së Projekt Propozimit Nxitës për zhvillimin e tregut të transportit ajror të Republikës së Kosovës, dhe dhënien e mendimit profesional, në mbledhjen e mbajtur me datën **19.11.2019** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluara, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatorë** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës tutje (Ref. Autoriteti) pas shqyrtimit të projektit strategjik zhvillimor konsideron se, incentiva të tilla, potencialisht ç'rregullojnë konkurrencën por kjo qështje duhet të trajtohen nga Komisioni për Ndhimën Shtetërore.
- III. Andaj, nga këndvështrimi i Autoritetit, sugjerojmë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, "Adem Jashari", që të kujdesën që, gjatë përzgjedhjes së operatoreve potencial, të cilët do të përfitojnë nga Programi Nxitës për Zhvillimin e Tregut të Transportit Ajror të Republikës së Kosovës, e që parakushtet e provueshmërisë në skemën e nxitjes nuk duhet të jenë të karakterit diskriminues dhe nuk do të përjashtojnë konkurrentet të cilët janë potencial për të kryer shërbime të caktuara të parapara në programin nxitës për zhvillimin e tregut.
- IV. Konkurrenca e mundshme (potential competition) përfshin mundësin e hyrjes në treg të konkurrentëve të rinj. Hyrjet e reja mund të vijnë nga konkurrentët që veprojnë në një treg gjeografik tjetër (për shembull, të huaja). Ndërmarrjet e tjera mund të hyjnë në treg nëse evitohen pengesat në hyrje ose ato janë të pranueshme dhe konkurruese. Pengesat mund të jenë ligjore ose mund të jenë kontraktuale (për shembull, kushtet kufizuese).

- V. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.
- VI. Autoriteti, lëshon këtë Mendim Profesional, duke e trajtuar kërkesën, nga pikëpamjet e Ligjit dhe politikave të konkurrencës.
- VII. Andaj, çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje diskriminuese dhe përjashtuese, do të jete nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**


(_____)
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


(_____)
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar


(_____)
Shaqir Morina
Anëtar